

MARRËVESHJE NDËRINSTITUCIONALE BASHKËPUNIMI

PËR MONITORIMIN E FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Sot, në datën 25.10.2006, midis Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të quajtura Palë këtu dhe më poshtë, në bazë dhe për zbatim të nenit 142 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003, i ndryshuar, nënshkruhet kjo Marrëveshje bashkëpunimi.

Palët në këtë Marrëveshje bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është angazhimi i Palëve, në përputhje me detyrimet përkatëse kushtetuese dhe ligjore, për përcaktimin e rregullave, për shfrytëzimin e kapaciteteve teknike të KKRT-së, për nevojat e monitorimit të fushatës zgjedhore, në radion dhe televizionin publik dhe privat, në funksion të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Neni 2

Palët në këtë Marrëveshje bashkëpunimi veprojnë në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit merr përsipër:

a) Të vërë në dispozicion të Bordit të Monitorimit të Medias (BMM) pajisjet teknike për monitorim.

b) Të vërë në dispozicion të BMM ambiente të mjaftueshme për kryerjen e monitorimit.

c) Të vërë në dispozicion të BMM studion e monitorimit dhe personelin teknik përkatës.

Neni 4

KQZ-ja merr përsipër shpenzimet financiare për pagesën e personelit që do të angazhohet për monitorim.

Neni 5

KKRT-ja merr përsipër të bëjë regjistrimin e sinjalit në mënyrë dixhitale deri në 15 operatorë radiotelevizivë.

Neni 6

Për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga kjo Marrëveshje, Palët veprojnë në bazë të kompetencave që u njeh ligji. Në këtë kuadër, KKRT-ja njeh rolin drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për monitorimin e operatorëve radiotelevizivë, në nivel kombëtar dhe vendor, dhe angazhohet për realizimin e detyrave që burojnë nga kjo Marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 7

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, 25.10.2006

PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË RADIO DHE TELEVIZIONIT KRYETARI Ledi Bianku	PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE KRYETARI Çlirim Gjata
---	---

